



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА - REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - ВЛАДА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVA			
ZYRA E KRYEMINISTRIT - УРЕД ПРОМИСТРА - OFFICE OF THE PRIME MINISTER			
SEKTOR: I ARKIVËS - СЕКТОР АРХИВЕ - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org.ëmbësht. Org. Unit	02.1.a	Nr. Dokumenti Doc. No.	103
Nr. Faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -	Data: Datum: Date:	28 01 / 20 25
Prishtinë/a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 28.01.2025

Mbledhja e 247-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 31.01.2025, në orën 09:30, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve dhe të transkripteve të mbledhjeve 238, 241 dhe 243 dhe të ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve 239, 240, 242, 244 dhe 245 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Listës së Artikujve për Përdorim të Përbashkët, që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik (MFPT)
3. Shqyrtimi i Draftit të Planit Kombëtar për Zhvillim për vitet 2025-2027 (ZKM)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e ndryshimeve në Tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për t'i përmbushur obligimet e pakryera financiare dhe kontraktuale nga viti paraprak (MFPT)
5. Shqyrtimi i Kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndarje të mjeteve buxhetore, për realizimin e "Projektit për Teknologji të Numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit dhe në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve" (MFPT)
6. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës për ndarjen e mjeteve buxhetore për ndihmat humanitare në Gaza (MFPT)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, Segmenti Dollc-Ramun (MMPHI)
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajt" (MMPHI)

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R-118 Mushtisht-Shtërpcë (MMPHI)
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25, Segmenti QMI-Lipjan (MMPHI)
12. Shqyrtimi i Kërkesës për pagesë të dyqindenjëzetekatër (224) specializantëve me vetëfinancim (MSh)
13. Shqyrtimi i Kërkesës për pagesë të tridhjetë (30) specializantëve me vetëfinancim nga Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi (MSh)
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronave të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (MM)
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Këshillit Organizativ për shënim të 17 shkurtit - Ditës së Pavarësisë (ZKM)
16. Të ndryshme